

2009

Çështja e ujërave të zeza: Momenti i fundit për menaxhim
më të mirë- rasti i Maqedonisë



Analytica

1/25/2009

Çështja e ujërave të zeza: Momenti i fundit për menaxhim më të mirë- rasti i Maqedonisë

Shkup, Janar 2009

Vendet e Evropës Juglindore (EJL) kanë pasur një reputacion të gjatë me dekada për moskujdesje ndaj rruajtjes së ambientit jetësor përmes mosrespektimit të ligjeve nacionale, gjë që çoi drejt rritjes së presioneve mbi resurset natyrore, ndër të cilat bëjnë pjesë edhe resurset ujore. Gjatë dekadave të fundit uji perceptoheste si resurs me tepri dhe mu për atë menaxhimi i drejtë nuk shiheshte si i nevojshëm. Problemet me ujin e pastërt në vendet aspiruese të EJL kanë filluar të trajtohen vetëm kohë më parë. Në këtë aspekt, janë sjellë shumë ligje për ndërtimin e një shoqërie racionale ndaj resurseve dhe të kujdesshme ndaj ambientit jetësor me qëllime afatgjate, me qëllim që të pengohet trendi i ndotjes së ujërave dhe përmirësimin e kualitetit të mjedisit jetësor.

Rritja e kërkesës për ujë në vend ndjek trendin e përgjithshëm të rritjes së popullsisë si dhe zhvillimin e shpejtë të saj. Kjo gjithashtu ka çuar drejt rritjes së nivelit të ujërave të zeza, duke nënkuptuar rritjen e ndotjes së ujërave kryesisht si pasojë e qëndrimit të papërgjegjshëm të njerëzve ndaj këtij burimi natyror, si dhe mungesa e mekanizmave për menaxhim dhe trajtim të këtyre ujërave në nivel lokal dhe nacional.

Egzistojnë shumë çështje që bëjnë presion mbi sektorin e ujërave, ndër të cilat janë:

- Shkalla e ulët e infrastrukturës së ujërave të zeza, shfrytëzimi joracional i ujit dhe kualiteti i dobët i kushteve në sipërfaqet ujore, së bashku me mbrojtjen e pamjaftueshme të kualitetit të ujërave;
- Furnizimi i dobët me ujë dhe çmime të ulëta të shërbimeve për ujëra;
- Investimet e pamjaftueshme në infrastrukturën e ujërave të zeza si dhe mospasja e mjeteve adekuate financiare për menaxhim të ujërave të zeza;
- Mungesa e implementimit substancial të legjislacionit i cili është në përputhje me EU acquis;
- Mungesa e strategjisë nacionale mbi ujëra për implementimin e Direktivës ujore kornizë dhe Planit kryesor të ujërave të cilët deri tash duheshte të kishin zëvendësuar Planin kryesor të ujërave të vitit 1976 (me ç'rast do të lejoheshte që të bëhet institucionalizim, organizim teritorial dhe proces palnifikimi adekuat në sektorin e ujërave);
- Kapacitetet administrative (burime njerëzore dhe financiare) janë ende të pamjaftueshme si në nivel lokal ashtu edhe në nivel nacional.
- Niveli i ulët i sistemit monitorues dhe mungesa e të dhënave.

Të gjitha këto çështje janë rezultat i neglizhencës ndaj ujërave nga ana e tërë shoqërisë. Ndikim kryesor për këtë gjendje kishte e kaluara e etiketuar me kujdes të pamjaftueshëm si dhe me mjete financiare të pamjaftueshme për trajtim të ujërave të zeza, duke lënë hapësirë për kualitet të dobët të pranuesve.

Si shtet kandidat për në UE, Maqedonia ballafaqohet me standarde të larta për mbrojtje të ujërave, të kërkuara nga Direktorati për zgjerim i Komisionit evropian. Ndryshimi i politikave në kualitetin dhe mbrojtjen e ujërave kërkohet urgjentisht. Ato duhet të detyrojnë koherencën ndër sektoriale në veçanti në industri dhe agrikulturë. Ujërat e zeza komunale dhe industriale të pamenaxhuara duhet të kenë konsideratë prioritare me vullnet politik në të dy nivelet – lokal dhe nacional, me ç'rast rënia e nivelit të ndotjes së ujërave dhe kontrolli i aplikuar mund të sigurojnë qëndrueshmëri të resurseve ujore si për gjeneratat e tashme ashtu edhe për ato të ardhshmet.

Gjithashtu është shumë e rëndësishme të pranohen sfidat turbulluese në sektorin e kualitetit të ujërave dhe të fillohet me punë serioze në ballafaqimin me sfidat e sipërpërmendura, pasi që rruga drejt UE-së por edhe ndryshimi i qëndrimit të Maqedonasve kundrejt ujit të pastërt natyrorë janë detyra tejet të vështira. Së fundmi, të gjithë ne si konsumatorë dhe prodhues të ujërave të zeza do të jemi kompetentët kryesorë për implementimin e Direktivave të UE-së lidhur me këto çështje.

Mjedisi jetesor, agrikultura dhe zhvillimi rural

Publikimet e meparshme:

Kompostimi në Maqedoni - Alternativë e shëndoshë apo vetëm një ide e "kalbur"?

Publikime te ardhshme:

Raport i shkurte: Performansat e Maqedonise ne sferen e ambientit jetesor. (Shkurt 2009)

Kontakt

Analitika

Dame Gruev 7-8/3
1000 Shkup, Maqedoni
tel: + 389 2 312 1948
web: www.analyticamk.org
info@analyticamk.org

***Hulumtues pergjegjes per programin
Mjedisi jetesor, agrikultura dhe zhvillimi rural***

Karolina Pendovska - hulumtues
kpendovska@analyticamk.org

Analitika - organizate e pavarur joprotabile e perkushtuar per te ndihmuar persona dhe institucione ne perforcimin dhe permiresimin afatgjate te demokracise dhe udheheqjes si ne R. e Maqedonise ashtu edhe me gjere ne rajon.

Analitika eshte organizate per analize dha hulumtim te politikave publike (think-tank), e perkushtuar ne promovimin dhe zhvillimin e bashkpunimit ndermjet subjekteve dhe organizatave ne R. e Maqedonise dhe me gjere.

Publikimi i raporteve eshte i mbeshtetur nga Fondi Evropian per Ballkanin, Projekti: "Ndertimi i kapaciteteve nacionale: Harmonizimi, legjislacioni dhe menaxhimi"